



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE INFORMIMIT PUBLIK
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 2626 Prot.

Patos, më 08/09 2025

Njoftim

**Dëgjese publike me temë:
“Plani 5- vjeçar i Strehimit 2025-2029”**

Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe kërkesë nr. 2626 prot., datë 28.08.2025 të Drejtorisë së Planifikimit të Projekteve dhe Emergjencave Civile.

Ju njoftojmë se:

Ditën e **Martë** në datë **07.10.2025 ora 10³⁰**, në ambientet e sallës së Këshillit Bashkiak do të organizohet takimi konsultativ me përfaqësues të: anëtarë të Këshillit Bashkiak, kryetarë të fshatrave, persona me aftësi ndryshe, shoqëri civile, qytetarë të bashkisë Patos, përfaqësues të bashkisë Patos dhe grupe të tjera interesi, lidhur mbi dëgjesën publike me temë: **“Plani 5- vjeçar i Strehimit Social 2025-2029”**.

Ky konsultim publik synon të njoh grupet e interesit me Planin 5- vjeçar të Strehimit 2025-2029 dhe të mbledh sugjerimet dhe rekomandimet lidhur me këtë dokument me qëllim përmirësimin e tij. Plani synon të ulë numrin e familjeve të pastreha dhe tu vij në ndihmë grupeve vulnerabël, personave me aftësi ndryshe etj.

Komentet dhe rekomandimet e grupeve të interesit janë të mirëpritura, brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit e të konsultimit publik në adresën e email-it: info@bashkiapatos.gov.al.

Pjesëmarrja juaj në këtë dëgjese publike është shumë e rëndësishme për garantimin e një procesi sa më transparent dhe gjithëpërfshirës.

KRYETARI

Fation Duro

